



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 533/1 prot.

Tiranë më 22.02.2024

Lënda: Mbi bashkërendimin e projektvendimit “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Migracionit 2024-2030 dhe Planin të saj të Veprimit 2024-2026”.

MINISTRISË SË BRENDSHME

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) ka administruar shkresën tuaj nr. 533 prot., datë 20.02.2024, me anë të së cilës dërgoni për bashkërendim projektvendimin “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Migracionit 2024-2030 dhe Planin të saj të Veprimit 2024-2026” (në vijim “projektvendimi”) si dhe dokumentet shoqëruese.

Nga shqyrtimi i projektvendimit të ridërguar, Strategjisë Kombëtare të Migracionit, Planin e Veprimit, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese, Zyra e Komisionerit vlerëson marrjen në konsideratë të sugjerimeve të dhëna nga ana jonë me shkresën nr. 1806/1 prot., datë 13.11.2023, të cilat janë përfshirë konkretisht në Planin e Veprimit në Zbatim të Dokumentit Strategjik të Migracionit 2024-2030.

Sa më sipër, Zyra e Komisionerit shprehet dakord me projektvendimin.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi